



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

## KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



### Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. \_\_\_\_\_/2021

Datë: 26.03.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 26 paragrafi 7 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.03.2021 pas diskutimit lidhur me pikën e 8 të rendit të ditës: lidhur me shqyrtimin e rekomandimit të MAPL-së për rishikimin e vendimit të Kuvendit 01 nr.011/01-7235 i datës 27.02.2020 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Lapidarit për Martirët dhe personat e pagjetur nga Lufta e fundit në Kosovë, e miratoi këtë:

### V E N D I M

1. Caktohet lokacioni për ngritjen e Lapidarit për Martirët dhe Personat e Pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë.
2. Lokacioni ku do të ngritet Lapidari caktohet në pjesën e ngastrës kadastrale P-70705044-01200-0. Z.K Kralan, P.SH Rrugë Publike në pronësi të Komunës së Gjakovës .
3. Lapidari për Martirët dhe Personat e Pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë do të ndërtohet nga Komuna e Klinës sipas dokumentacioneve përkatëse dhe parametrave që i ofron Lokacioni i caktuar .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
5. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Anton Shala